

BULETINI MUJOR



JANAR 2024

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



U DORËZOHET KARTA E AUTONOMISË MENAXHERIALE QSUNT-SË DHE KATËR SPITALEVE RAJONALE DURRËS, SHKODËR, VLORË DHE LEZHË

Pas Spitalit Rajonal "Memorial" në Fieri, edhe pesë spitale të tjera në vend kanë përfitur Kartën e Autonomisë Menaxheriale, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Spitali Rajonal Durrës, Spitali Rajonal Shkodër, Spitalit Rajonal Lezhë dhe Spitalit Rajonal Vlorë.

Me Autonominë Menaxheriale të gjithë këto qendra spitalore do mund të ofrojnë standarde më të larta për qytetarët, kushte dhe paga më të mira për mjekët dhe progres e modernizim të sektorit. Objektiv mbetet krijimi i poleve të ekselencës në shëndetësi të shtrira në të gjithë vendin.



SË SHPEJTI NIS INVESTIMI PËR RIKONSTRUKSIONIN E SPITALIT TË GJIROKASTRËS, PËRFITOJNË RRETH 57 MIJË QYTETARË

Një tjetër investim i ri në infrastrukturën spitalore me mbështetjen e buxhetit të shtetit do të nisë së shpejti. Rikonstruksioni i godinës së Spitalit Rajonal të Gjirokastrës do të mundësojë transformimin e ambienteve për mjekët dhe infermierët si dhe do të rrisë shpejtësinë dhe cilësinë e shërbimit shëndetësor për rreth 57,000 qytetarë të Gjirokastrës.



KANTIERI I SPITALIT TË RI TË KRUIJËS, BUXHETI 2024/ INVESTIMET NË STRUKTURA SPITALORE DO TË SHTRIHEN NË TË GJITHË VENDIN

Vijojnë punimet për ndërtimin e Spitalit të ri të Kruijës "Dr. Stefan Gjoni". Investimi për rindërtimin e godinës së këtij spitali përfshin jo vetëm transformimin e ambienteve për stafin shëndetësor dhe qytetarët, por edhe zgjerim të kapaciteteve. Spitali i ri i Kruijës do t'u ofrojë një shërbim sa më cilësor afro 83 mijë qytetarëve të kësaj zone. me buxhetin e vitit 2024 në të gjithë vendin do të shtrihen Kantieret e reja të infrastrukturës spitalore.



KRIJOHET QENDRA E PARË SPITALORE RAJONALE "SHEFQET NDRUQI"

Qendra e parë Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" u krijua si një "binjakëzim" me menaxhim unik të Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" me Spitalin Bashkiak të Kavajës. Pas një dekade investimesh në sektorin e shëndetësisë, tashmë po krijohen qendra ekselence për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore më afër qytetarëve, pa qenë nevoja që të shkojnë në Tiranë. Krijimi i qendrave rajonale, një model i ri menaxhimi spitalor, do të shtrihet në të gjithë vendin.



MINISTRJA KOÇIU NË SPITALIN E SARANDËS: SHËRBIME CILËSORE PËR QYTETARËT DHE MIJËRA TURISTË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu ka zhvilluar një vizitë në Spitalin e Sarandës "Petro Nako" ku investimet e qeverisë dhe MSHMS-së në kirurgji, maternitet dhe pediatri kanë mundësuar kushte bashkëkohore për stafin si dhe cilësi shërbimi pranë vendbanimit për qytetarët.

Ky spital u shërben rreth 120 mijë banorëve dhe mijëra turistëve të cilët e zgjedhin atë si destinacionin e pushimeve të tyre.



SHËRBIMI SHËNDETËSOR NË SHTËPI PËR TË MOSHUARIT DO TË SHTRIHET NË TË GJITHA QENDRAT SHËNDETËSORE

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu gjatë një bashkëbisedimi me të moshuar në Gjirokastrë të cilët janë edhe përfitues të shërbimeve mjekësore e paketave shëndetësore falas, theksoi se shërbimi shëndetësor në shtëpi për të moshuarit do të shtrihet në të gjitha qendrat shëndetësore.

Me rikonstruksionin e Spitalit të Gjirokastrës do të fuqizohet flota e pajisjeve dhe burimeve njerëzore për të ofruar shërbime më të mira për të gjithë qytetarët e Gjirokastrës dhe qarkut në tërësi. Po ashtu për të gjithë turistët e këtij qyteti të bukur, të cilët do të kenë nevojë për akses në shëndetësi.



POLIKLINIKA E SHKODRËS DREJT PËRFUNDIMIT, SHËRBIME CILËSORE PËR 200 MIJË BANORË NË 19 SPECIALITETE

Rikonstruksioni i Poliklinikës së Specialiteteve "Bahri Koplaku" në Shkodër, në kuadër të programit të rehabilitimit të infrastrukturës së kujdesit shëndetësor, vijon rikonstruksionin.

Me ambientet dhe kushtet bashkëkohore për stafin mjekësor, si dhe aparatura të teknologjisë së fundit, Poliklinika e Shkodrës do të ofrojë akses të shpejtë dhe shërbime cilësore për 200 mijë banorë në 19 specialitete të ndryshme.



RIKONSTRUKSIONI I POLIKLINIKËS SË SPECIALITETEVE NË DURRËS, SHËRBIME CILËSORE PËR 290 MIJË BANORË

Në Durrës vijnë me intensitet punimet për rikonstruksionin e Poliklinikës së Specialiteteve, e cila me ambientet pritëse të zgjeruara, kushtet bashkëkohore për stafin mjekësor, si dhe pajisjet e teknologjisë së fundit, do të ofrojë akses të shpejtë dhe shërbime cilësore ambulatorie në 17 specialitete të ndryshme dhe ekzaminime laboratorike për 290 mijë banorë.



NIS SË SHPEJTI RIKONSTRUKSIONI I SPITALIT TË LEZHËS, SHËRBIME MË TË MIRA PËR RRETH 200 MIJË QYTETARË

Spitali Rajonal i Lezhës do të rikonstruktoret tërësisht duke rritur gamën e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Lezhës. Me nisjen e shpejti të rikonstruksionit, ky spital do të marrë një fazë zhvillimi të mëtejshme, krahas maternitetit i cili ofron kushte tërësisht bashkëkohore.

Ky investim do të mundësojë rritjen e cilësisë së shërbimit për rreth 200 mijë banorë si dhe transformimin e ambienteve për mjekët dhe pacientët.